

VENDIM
Nr.1269, datë 17.9.2008

**PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E
PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHETËTËRORE, TË NGARKUARA PËR
SHQYRTIMIN E VLEFISHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË
PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE¹**

*(Ndryshuar me VKM nr.1040, datë 14.10.2009; nr.92, datë 10.02.2010; nr.144, datë 23.02.2011;
nr.1040, datë 4.12.2013; nr.21, datë 22.01.2014; nr.697, datë 5.10.2016)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, me propozimin e *Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. PËRBËRJA, MËNYRA E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E
KOMISIONIT QEVERTAR TË TOKËS (KQT)**

A. Përbërja dhe mënyra e funksionimit

1. Komisioni Qeveritar i Tokës kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe përbëhet nga:

*-Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
zëvendëskryetar;*

- Ministri i Punëve të Brendshme anëtar;

- Ministri i Drejtësisë anëtar;

- Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit anëtar.

Kur për shkaqe të arsyeshme, ministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit Qeveritar të Tokës, atëherë ai duhet të kërkojë paraprakisht, me shkrim, duke paraqitur këto shkaqe, miratimin e Kryetarit. Në vend të tij, me miratimin me shkrim të Kryetarit, merr pjesë, me të drejtë vote, zëvendësministri i autorizuar nga ministri.

Në mbledhjen e Komisionit Qeveritar të Tokës merr pjesë rregullisht, pa të drejtë vote:

- Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë,

- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit të Burimeve dhe Ofrimit të Shërbimeve në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

2. Anëtarët e KQT-së ndjekin zbatimin e vendimeve të tij në institucionet, që drejtojnë dhe, për vështirësitë që dalin, informojnë, në çdo kohë, kryetarin e këtij komisioni.

3. Mbledhjet e KQT-së zhvillohen në datën dhe orën e njoftuar nga kryetari ose, në mungesë dhe me porosi të tij, nga zëvendëskryetari, jo më pak se një herë në tre muaj, por në raste të veçanta, që vlerësohen nga kryetari, ky komision mund të mbledhet në çdo kohë.

¹ VKM nr.1269, datë 17.09.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.150/2008.

VKM nr.1040, datë 14.10.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.159/2009.

VKM nr.92, datë 10.02.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.24/2010.

VKM nr.1040, datë 4.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.195/2013.

VKM nr.21, datë 22.01.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4/2014.

VKM nr.697, datë 5.10.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.189/2016.

4. Vendimet e KQT-së merren me votim të hapur dhe quhen të vlefshme, kur votojnë “pro” më shumë se 50 për qind e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Anëtarit të KQT-së nuk i lejohet të abstenojë.

Anëtari, që voton kundër, mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënohet fakti dhe arsyet e votimit kundër.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë

KQT-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Shqyrton dhe miraton, në mbledhjen e parë të çdo fillimviti, programet vjetore të kontrollit dhe të verifikimit, të përgatitura nga komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV-të).

2. Pasi shqyrton propozimet e KV-ve, të sekretariatit teknik apo/edhe kryesisht për masat disiplinore dhe administrative, për të gjitha institucionet, organet, strukturat dhe subjekte të tjera, që, me veprimet ose mosveprimet e tyre, kanë penguar përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga dispozitat e ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, e të akteve nënligjore, në zbatim të tij, si dhe vendimeve të këtij komisioni, merr vendime në përputhje me pikën 5 të nenit 6 të ligjit të sipërpërmendur.

3. Shqyrton ankesat e palëve ndaj veprimeve të KV-ve, të paraqitura pranë KQT-së nga sekretariati teknik, dhe merr vendimet përkatëse.

KQT-ja nuk merr në shqyrtim ankesat, për të cilat KV-të kanë paraqitur kërkesat përkatëse në organet gjyqësore, në kuptim të zbatimit të neneve 10, 12, 13 e 15 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

4. Merr vendime për zgjidhjen e konflikteve territoriale, ndërmjet qarqeve për kufijtë e zërit kadastral të tokës bujqësore, në bazë të raporteve paraprake, të përgatitura nga sekretariati teknik.

5. Thërret në raport prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e komunave dhe/ose bashkive, si dhe drejtuesit e strukturave të tjera shtetërore, veprimtaria e të cilave lidhet me krijimin e titujve të pronësisë mbi tokën, për çdo rast, kur kjo vlerësohet e nevojshme nga kryetari i KQT-së teknik.

6. Merr vendime për mënyrën e organizimit të veprimtarive të KV-ve, mënyrën e kryerjes së verifikimeve, të përgatitjes dhe mbajtjes së dokumentacionit, për llojin e informacionit, që paraqitet në komision, afatet e përmbushjes së detyrimeve për çështje konkrete të shqyrtimit dhe të verifikimit të titujve të pronësisë, mënyrën e bashkëveprimit me institucione të tjera, veprimtaria e të cilave lidhet me verifikimin e titujve të pronësisë, të bazuara në dispozitat e ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

II. PËRBËRJA, MËNYRA E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E SEKRETARIATIT TEKNIK TË KQT-SË

A. Përbërja dhe mënyra e funksionimit

1. Sekretariati teknik i KQT-së krijohet si strukturë e veçantë administrative, teknike, në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në shërbim të KQT-së.

2. Shfuqizuar.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik

Sekretariati teknik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Administron të gjitha ankesat, kërkesat ose informacionet e paraqitura me shkrim nga

shtetas, institucione ose struktura shtetërore, veprimtaria e të cilave ka për objekt ndarjen e tokës dhe krijimin e titujve të pronësisë mbi të, të regjistruara në protokollin e *Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

Ankesat, kërkesat dhe informacionet e administruara, në mbështetje të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, grupohen sipas përmbajtjes, rëndësisë dhe përgjegjësisë për zgjidhjen e tyre dhe paraqiten:

- a) për shqyrtim në KQT;
- b) për shqyrtim ose rishqyrtim në KV.

Kur ankesat, kërkesat dhe informacionet e administruara nuk kanë për objekt të drejtpërdrejtë shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, sekretariati teknik i trajton ato sipas dispozitave të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

2. Përgatit mbledhjet e KQT-së, sipas rendit të ditës, të miratuar paraprakisht nga kryetari i këtij komisioni, i cili u njoftohet anëtarëve pesë ditë para mbledhjes, çështjet e përgjithshme e të veçanta për shqyrtim, si dhe projektvendimet përkatëse.

3. Mban procesverbalin e mbledhjes së KQT-së, që nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i këtij komisioni.

4. I paraqet KQT-së programet vjetore të dërguara nga KV-të së bashku me komentet, vërejtjet dhe propozimet e tij.

5. Përgatit përgjigjet përkatëse për ankesat, kërkesat dhe informacionet e paraqitura nga shtetasit, institucionet ose strukturat shtetërore për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij.

6. Përgatit aktet e KQT-së, të cilat duhet të përmbajnë numrin e vendimit dhe datën e marrjes së tij, në dy kopje, të nënshkruara nga *Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin* dhe të vulosura me vulën e Këshillit të Ministrave. Një kopje ruhet në arkivin e Këshillit të Ministrave dhe kopja tjetër në arkivin e *Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave* 7. Ia përcjell të gjitha vendimet e KQT-së institucioneve apo individëve, të shoqëruara me shkresë përcjellëse, të nënshkruara nga drejtori i sekretariatit teknik. Të gjitha këto vendime do të vulosen me vulën e *Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave* dhe do të jenë të protokolluara në regjistrat e protokollit të kësaj ministrie.

8. Mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e KV-ve, ndërmjet dy mbledhjeve të KQT-së, nëpërmjet informacioneve të marra prej tyre dhe të kontrollove të drejtpërdrejta, që ushtron mbi to, në zbatim të vendimeve, që merr KQT-ja.

III. PËRBËRJA, MËNYRA E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT VENDOR TË VLERËSIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË (KV)

A. Përbërja dhe mënyra e funksionimit

1. Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë krijohet si strukturë e veçantë, pranë prefektit të qarkut, me numër punonjësish, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Anëtarët e komisioneve vendore duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme, të përcaktuara me ligjin e shërbimit civil, si dhe kërkesat e veçanta, të formuluar nga kryetari i KQT-së.

Ata emërohen, lirohen apo shkarkohen nga detyra nga prefekti i qarkut.

Ata duhet të jenë juristë, agronomë apo inxhinierë gjeodetë ose, në pamundësi, teknikë topografë të licencuar.

Komisionet vendore prej 3 (tre) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 1 (një) jurist.

*Komisionet vendore prej 5 (pesë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 3 (tre) juristë.
Komisionet vendore prej 6 (gjashtë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 4 (katër) juristë.
Komisionet vendore prej 7 (shtatë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 5 (pesë) juristë.
3. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e komisioneve vendore rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.*

4. Prefekti i qarkut, për raste të domosdoshme, mund të angazhojë pranë KV-ve edhe punonjës të përkohshëm, për të kryer shërbime mbështetëse.

5. Drejtori i KV-së është përgjegjës për organizimin dhe përmbushjen e detyrave. Prefekti përgjigjet para KQT-së për funksionimin e KV-së.

6. KV-ja funksionon si organ kolegjal, si më poshtë vijon:

a) Mbledhjet e këtij komisioni thirren dhe drejtohen nga prefekti. Në mbledhje, prefekti mund të thërrasë edhe drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen.

Në mbledhjen e KV-së paraqitet për shqyrtim informacioni përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektet e interesuara, dokumentacioni, që ka lidhje me çështjen, dhe propozimi përkatës.

Për çdo informacion, përveç relatorit përkatës ose grupit të punës, që ka verifikuar çështjen, çdo pjesëtar i KV-së është i detyruar të shprehë mendimin e vet, i cili shënohet në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KV-së, pjesëmarrës në mbledhje.

b) Vendimet merren vetëm në praninë e anëtarëve të KV-së dhe të prefektit, me votim të hapur. Vendimet quhen të vlefshme kur votojnë “pro” më shumë se 50 për qind e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KV-së.

Prefekti nuk merr pjesë në votim, por është përgjegjës për mbarrëvajtjen dhe respektimin e procedurave.

Të gjitha vendimet e KV-së, përveç atyre, që kanë për objekt kundërvajtjet administrative, nënshkruhen nga prefekti, si dhe nga drejtori i KV-së.

Kur prefekti vëren shkelje të procedurave, ai mund t’i kontestojë vendimet e KV-së, duke mos i nënshkruar ato, e duke i kërkuar më pas KQT-së, ta gjykojë rastin dhe të vendosë për to.

Vendimet e KV-së janë akte administrative dhe përgatiten në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ato vulosen me vulën e institucionit të prefektit dhe u dërgohen të gjitha subjekteve të interesuara.

c) Drejtori ose çdo pjesëtar i KV-së, i autorizuar prej tij, përfaqëson KV-në në proceset gjyqësore të të gjitha shkallëve, që kanë si objekt shqyrtimet e vendimeve të KV-së.

ç) Korrespondenca shkresore e KV-ve me institucionet e tjera dhe shtetasit mbahet në përputhje me të gjitha rregullat, sipas të cilave funksionon administrata e prefektit.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë

Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Pas verifikimit të dokumentacionit zyrtar dhe veprimtarisë së kryer nga ish-komisionet e tokës së fshatit, komunës dhe/ose bashkisë, si dhe komisioni i tokës së qarkut (ish-rrethit) në procesin e ndarjes së tokës, arrin në përfundime të bazuara ligjore dhe merr vendime:

a) për saktësimin e kufijve të tokës bujqësore, ndërmjet rretheve, brenda juridiksionit të qarkut, ndërmjet komunave dhe/ose bashkive, brenda rrethit, si dhe ndërmjet fshatrave (subjekteve), brenda territorit të komunës dhe/ose bashkisë;

b) për konfliktet ndërmjet familjeve bujqësore ose individëve të një fshati, si dhe ndërmjet tyre dhe ish-komisioneve të ndarjes së tokës;

c) në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”. Vendimet, krahas paraqitjes në

gjykatë, i dërgohen edhe zyrës vendore të Avokaturës së Shtetit dhe, për dijeni, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit;

ç) të tjera, në përputhje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, dalë në zbatim të tij, si dhe të vendimeve të KQT-së.

2. Kryen vlerësimin ligjor të krijimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të plotësuara nga kryetarët e bashkive, për familjet bujqësore ose individët, në rastet e kërkesave të paraqitura nga qytetarët apo institucionet shtetërore, në territoret e:

a) ish-kooperativave bujqësore, në zbatim të pikës 1/1, të nenit 17, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar;

b) ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 57/2012, “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, dhe të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar.

Komisioni vendor vlerëson aktet e marrjes së tokës në pronësi, të plotësuara nga kryetarët e bashkive, për bazueshmërinë ligjore të tyre dhe merr vendim për rikonfirmimin e tyre, në rastet kur:

a) vërtetohet se familja bujqësore ose individ, në emër të të cilit lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, është subjekt i përfitimit të tokës bujqësore në pronësi, sipas ligjeve të sipërpërmendur;

b) verifikohet se sipërfaqja, për të cilën është lëshuar akti i marrjes së tokës në pronësi, është objekt i trajtimit sipas ligjeve të sipërpërmendur dhe madhësia e saj është në përputhje me përcaktimet ligjore;

c) janë krijuar në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjet e sipërpërmendur.

3. Rishqyrton, në rrugë administrative, konfliktet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, në rastet kur kjo është kërkuar me vendim të formës së prerë të organeve gjyqësore. Në këtë rast, KV-ja, brenda 20 ditëve nga data e vendimit të organeve gjyqësore, merr vendim përfundimtar, për zgjidhjen e konfliktit, përmbajtja e të cilit u njoftohet palëve.

4. Dërgon për regjistrim në ZVRPP vendimin gjyqësor përfundimtar për sipërfaqet e tokës të liruara nga fitimi, mbajtja dhe përdorimi i paligjshëm i tyre, që kalojnë në pronësi të shtetit, pas procedurave të realizuara sipas përcaktimeve të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Pjesë e detyrueshme e këtij vendimi është planvendosja e ngastrës/ave.

Për këto sipërfaqe toke KV-ja harton, së bashku me DAMT-in, pranë Këshillit të Qarkut, procesverbalin përkatës, në përmbajtje të të cilit pasqyrohen vendndodhja (fshati dhe bashkia, zona kadastrale), numri dhe lloji kadastral i ngastrës, sipas regjistrit të DAMT-it, sipas sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe sipërfaqja e saj, i shoqëruar me planvendosjen e ngastrës/ave. Përgjegjësi i DAMT-it, pas marrjes së kopjes së procesverbalit dhe në mbështetje të tij, njofton për këtë veprim edhe bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet toka.

Komisioni vendor, një kopje të vendimit gjyqësor përfundimtar, të planvendosjes së ngastrës/ave dhe procesverbalit, për ngastrat që ndodhen në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i paraqet në Agjencinë e Trajtimit të Pronës. Këto sipërfaqe të tokës përdoren për fondin e kompensimit fizik, në zbatim të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Përgjegjësi i DAMT-it, pas marrjes së kopjes së procesverbalit dhe në mbështetje të tij, për ngastrat që ndodhen në territorin e ish-kooperativave bujqësore, e paraqet atë në bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet toka, për t’u administruar sipas dispozitave të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”.

Komisionet vendore kanë detyrimin që, brenda dy muajve, nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin në Agjencinë e Trajtimit të Pronës të gjitha vendimet gjyqësore përfundimtare, të marra para kësaj date, të shoqëruara me planvendosjet e ngastrës/ave dhe procesverbalin/et

përkatës.

5. Harton programin e veprimtarive për kontrollet dhe verifikimet, si dhe për zbatimin e vendimeve të KQT-së, në kuptim të shkronjave “b” e “ç” të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

Analiza e realizimit të këtij programi bëhet nga KV-ja në fund të çdo viti.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për çdo pjesëmarrje në mbledhje anëtarët e KQT-së, përfitojnë një shpërblim, në masën 5000 (pesë mijë) lekë.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme që, për çdo vit, të planifikojë, në buxhetin vjetor të institucionit të prefektit të qarkut, si zë të veçantë, një fond për mbulimin e shpenzimeve të KV-së, sipas propozimeve të komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefekturave dhe të paraqitura nga sekretariati teknik pranë KQT-së.

3. Ngarkohen KQT-ja dhe Ministria e Brendshme për përgatitjen e akteve për krijimin, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të strukturave të përcaktuara në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucioni i prefektit të krijojnë kushtet normale dhe bazën materiale të nevojshme për vënien në funksion të plotë të sekretariatit teknik të KQT-së dhe të KV-ve në qarqe.

5. Vendimi nr.230, datë 22.7.1991 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRË ANALITIKE E PËRLLOGARITJES SË KOSTOVE PËR STRUKTURAT SHTETËRORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE

I-Për PBMUK:

a) kosto e personelit (600-601)

1- Sekretariati teknik i KQT-së	Nr.	Paga bruto vjetore në 000/lekë	Paga bruto (tetor- dhjetor)2008 në 000/lekë
Shuma	(5)	3300	825

- Paga bruto është përcaktuar sipas tabelës përkatëse të VKM për pagat të krahasueshme në ministri.

b) shpenzime operative (602)

	vjetore në 000/lekë	(tetor-dhjetor) 2008 000/lekë
--	------------------------	----------------------------------

1. Për sekretariatit teknik të KQT-së	1565	391
(karburant, dieta, të tjera)		
2. Për veprimtarinë e KQT-së	455	180

Shuma	2020	571
Totali (a+b) për MBUMK	5320	1396

II- Për KV të administratës së prefektit të qarkut:

a) kosto e personelit
(600-601)

Nr.

Paga bruto
vjetore
në 000/lekë

Paga bruto
(tetor-dhjetor) 2008
në 000/lekë

Shuma	60	48450	12306
-------	----	-------	-------

- Paga e drejtorit të KV-së është barazuar me pagën e përgjegjës të sektorit në ministri (III-a); ndërsa paga e specialistëve të KV-së është barazuar me pagën e specialistit në ministri (IV-a)

b) Shpenzime operative (602) për KV-të
(karburante, dieta, kancelari etj.)

Vjetore
000/lekë
31260

(tetor-dhjetor)2008
000/lekë
7815

Totali (a+b) për KV-të në qarqe	79710	20121
---------------------------------	-------	-------

LIDHJA NR.1

NUMRI I PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE SHTETËRORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË DHËNIES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI DHE FINANCIMI NGA BUXHETI I SHTETIT TË VEPRIMTARISË SË TYRE

Nr.	Emërtimi i institucionit	Numri i punonjësve	Kosto në 000/lekë Deri në fund të vitit 2008 (tetor-dhjetor)		
			Gjithsej	Personeli (600-601)	Shpenzime operative 602
I	Për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (Komisioni qeveritar dhe sekretariati teknik)	5	571	Mbulohet nga buxheti ekzistues i MBUMK	571
II	Për prefekturat e qarqeve:	60	20121	12306	7815
1	Berat	3	1015.9	624.9	391
2	Dibër	3	1015.9	624.9	391
3	Durrës	6	2031.8	1249.8	782
4	Elbasan	5	1660.5	1009.5	651
5	Fier	6	2031.8	1249.8	782
6	Gjirokastrë	3	1015.9	624.9	391
7	Korçë	6	2031.8	1249.8	782
8	Kukës	3	1015.9	624.9	391
9	Lezhë	5	1660.5	1009.5	651
10	Shkodër	6	2031.8	1249.8	782
11	Tiranë	7	2304.1	1394.1	910
12	Vlorë	7	2305.1	1394.1	911

TOTALI (I+II)	65	20692	12306	8386
---------------	----	-------	-------	------